



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Ndikimi i COVID-19 në punësimin e të rinjve në Shqipëri



HUB Rinor

BALLKANI PERENDIMOR DHE TURQIA

Ky dokument politikash u përgatit si pjesë e projektit WB&T for EmploYouth, financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti zbatohet nga Ana and Vlade Divac Foundation (Serbi), Prima Association (Mali i Zi), Association for education Mladiinfo International (Maqedonia e Veriut), Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (Shqipëri) dhe Community Volunteers Foundation (Turqi).

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Hulumtues

Ariola Memia

Të rinjtë shqiptarë po përballen me sfida dhe vështirësi të cilat kushtëzojnë çdo ditë jetesën e tyre brenda vendit. Kjo konfirmohet jo vetëm nga vetë ata, por edhe nga të dhënat zyrtare të cilat tregojnë se të rinjtë gjithnjë e më shumë kërkojnë të largohen nga Shqipëria. Ndërkohë vendit i mungojnë politikat për të adresuar çështjet më shqetësuese për rininë; duke filluar me punësimin dhe duke vazhduar me sigurimin e alternativave të tjera për angazhimin e tyre në tregun e punës. Nga ana tjetër, niveli i papunësisë tek të rinjtë ka njohur ulje në vitet e fundit pasi tregu është bërë më dinamik për shkak të zhvillimit të bizneseve “call-center” dhe për shkak të një performance më të mirë të sektorit të shërbimeve, sidomos turizmit. Në të njëjtën kohë, kërkesa për punë ka pësuar rënie pasi shumë të rinj i janë drejtuar tregut ndërkombëtar dhe janë angazhuar në punë të ndryshme, me anë të kontratave të përhershme apo atyre sezonale. Ndërkohë emigrimi dhe rënia e lindjeve po sjellin një rënie dramatike të numrit të të rinjve, një fenomen që pritet të ketë ndikime negative afatgjata dhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Sipas të dhënave nga Instituti i Statistikave, niveli zyrtar i papunësisë së të rinjve ishte 20.7% në tremujorin e tretë të vitit 2020 dhe në terma vjetor shkalla e papunësisë së të rinjve paraqet një tendencë në rënie. Gjithashtu, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2019, shkalla e papunësisë së të rinjve është 0.7 përqind më e ulët. Ndërkohë, brenda popullatës së të rinjve jo-ekonomikisht aktivë të moshës 15-29 vjeç, 67.2% janë nxënës/studentë ose që ndjekin një trajnim (NEET) ndërsa 8.5% klasifikohen si punëtorë të dekurajuar[1]. Por përtej të gjithë këtyre të dhënave, gjetja e një pune në tregun vendas mbetet një sfidë e vërtetë për të rinjtë. Sipas EUROSTAT, numri i të rinjve shqiptarë që janë larguar nga vendi në dekadën e fundit ka arritur në 140,390. Kjo shifër tregon ata të rinj që kanë kërkuar azil në vendet evropiane gjatë 10 viteve të fundit ndërkohë që kërkesat për të lënë vendin gjatë vitit 2019 u rritën në mënyrë të ndjeshme (me 24%), duke e renditur vendin tonë në mesin e vendeve që rrezikojnë plakjen e shpejtë të popullsisë në një plan afatgjatë dhe shpopullimin e saj[2].

Përsëri, sipas të dhënave administrative mbi tregun e punës të raportuara nga Instituti i Statistikave, pothuajse 19,000 të rinj të moshës 15-29 vjeç u regjistruan si punëkërkues në zyrat e punësimit gjatë gjysmës së parë të vitit 2020 ose 16% më shumë se në gjysmën e parë të vitit 2019. Ky ishte niveli më i lartë i punëkërkuesve të papunë që nga tremujori i fundit i vitit 2016. Nga ana tjetër, pandemia e COVID-19 po reflekton ende pasojat e saj negative të cilat përtej aspektit shëndetësor, kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në financat e të rinjve në Shqipëri ku një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë humbur punën që nga marsi i vitit 2020.

[1] Anketa Tremujore e Forcës së Punës, Tremujori i Tretë, INSTAT 2020
[2] “Rinia në Shqipëri 2020” CRCA

Sipas Anketës Tremujore të Forcës së Punës[3], në tremujorin e dytë të vitit 2020, rezulton se numri i të punësuarve të moshës 15-29 vjeç ishte 262,000, ose rreth 20,000 më pak të punësuar krahasuar me tremujorin e parë të vitit. Ndërkohë, duke marrë parasysh të dhënat nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, arsyeja kryesore për praninë e niveleve të larta të papunësisë së të rinjve është mungesa e ofertës për punë. Aktualisht në portalin e Agjencisë ka vetëm 59 oferta pune nga bizneset[4]. Në vitet e mëparshme, ofertat për punë nga sektori i biznesit, arrinin shifrën e rreth 40,000 të tilla. Sërish duke ju referuar të dhënave nga Instituti i Statistikave, pushimet nga puna më të mëdha gjatë pandemisë u aplikuan nga sektori i shërbimeve (kafe, bare dhe restorante), ku punësimi u ul me 31.8 %, pasuar nga hotelet me 20.2% dhe fabrikat me 12.8%. Punësimi në përgjithësi dhe punësimi për të rinjtë u ulën dhe në disa tregje të tjera të shërbimeve siç janë aktivitetet inxhinierike, me 2.5%, komunikimi me 2.3%, tregtia dhe riparimi i automjeteve me 2.2% sidhe agjencitë e udhëtimit me 2.1%.

Nga ana tjetër, në disa linja të tjera shërbimesh, tregu duket sikur nuk është prekur nga pandemia e COVID-19. Furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve shënuan një rritje të konsiderueshme të punësimit (me 4.6%) krahasuar me tremujorin e dytë të vitit. Kjo rritje duket se është nxitur nga punësimi në ndërmarrjet shtetërore, pasi shumica dërrmuese e tyre janë në pronësi publike. Sektori i ndërtimit gjithashtu rezultoi të kishte një rritje vjetore prej 1.9 % gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020.

Sektori nuk e ndaloi aktivitetin e tij as gjatë periudhës kur u aplikuan masat kufizuese dhe fillimi i procesit të rindërtimit në zonat e dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit të 2019-ës duket sikur stimuloi punësimin në ndërtim. Sektori i energjisë elektrike gjithashtu pati një rritje të punësimit me rreth 1.2%. Prodhimi i energjisë elektrike nuk është prekur nga kriza pasi është ndikuar dhe nga rritja e investimeve në hidrocentrale të cilat kanë qenë në ndërtim e sipër.

[3] Anketa Tremujore e Forcës së Punës, Tremujori i Dytë, INSTAT 2020
[4] Në datë 06/01/2021

Gjatë dekadës së kaluar, punësimi i të rinjve ka marrë një rëndësi të konsiderueshme në disa nga agjendat kombëtare, duke vënë në dukje sfidën me të cilën Shqipëria akoma përballlet pavarësisht zhvillimeve në kontekstin socio-ekonomik. Gjatë vitit të kaluar, punësimi i të rinjve ka qenë edhe në fokus të diskutimit mes institucioneve publike dhe private duke marrë parasysh dhe pasojat që pati pandemia e COVID-19 mbi punësimin e këtyre të fundit.

Ndërkohë ka pasur disa masa dhe politika që qeveria shqiptare i ndërmori që nga fillimi i karantinës në muajin mars 2020. Një ndër më të rëndësishmet ishte ndryshimi i Buxhetit të vitit 2020 sipas Aktit Normativ të 20 mars 2020 me synimin për të mbështetur shtyllat kryesore të përpjekjeve kundër pasojave të pandemisë globale, duke siguruar 6.5 miliardë lekë Fond për “Paketën Sociale Anti-COVID “në mbështetje të punonjësve dhe / ose shtresave të tjera të prekura nga pezullimi i punës në të gjithë vendin, përfshirë shtresat në nevojë, të papunët dhe komunitetin. Gjithashtu si pjesë e masave lehtësuese u deklaruan 1 miliard lekë të tjera në drejtim të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, për krijimin e hapësirës për financimin e shpenzimeve të tjera nevojshme dhe 2 miliardë lekë realokime në një Fond emergjence për të siguruar furnizimin me ushqim, grupeve të caktuara të cilat do preken nga pandemia, familjeve që marrin ndihmë ekonomike apo pensionistëve të cilët do të kenë nevojë për ndihmë të drejtpërdrejtë[5]. Është e rëndësishme të theksohet se nuk mund të flitet për një ndikim të qartë që këto masa kanë pasur për të rinjtë në vendin tonë duke marrë parasysh që të dhënat e Institutit të Statistikave tregojnë që nga 33,000 persona të cilët kanë humbur punën e tyre gjatë periudhës prill - qershor 2020, 61% e tyre ishin të rinj, të moshës 15-29 vjeç.


[5] <https://financa.gov.al/raporte-per-covid-19>

Aktorët kryesorë përgjegjës për hartimin e politikave të tregut të punës në vend duhet të marrin në konsideratë masa shtesë që lidhen posaçërisht me kategorinë e të rinjve të moshës 15-29 vjeç duke mbajtur parasysh që 22,000 të rinj kanë humbur punën vetëm gjatë periudhës prill - qershor 2020.

Institucionet publike duhet të jenë të vetëdijshme se punësimi produktiv i të rinjve nuk mund të arrihet përmes ndërhyrjeve të fragmentuara/të izoluara dhe se ekziston një nevojë urgjente për veprime të qendrueshme të cilat njëkohësisht kërkojnë përfshirjen e një gamë të gjerë aktorësh.

Institucionet publike dhe aktorët kryesorë përgjegjës për punësimin e të rinjve duhet të punojnë në mënyrë proaktive për një strategji integruese e cila mundëson krijimin e vendeve të reja të punës, dhe, në të njëjtën kohë, të gjitha ndërhyrjet e synuara do të ndihmonin të rinjtë shqiptarë të kapërcenin vështirësitë që kanë hasur për shkak të pandemisë së COVID-19.

Është e nevojshme të kemi një koordinim dhe bashkëpunim më të mirë midis institucioneve qeveritare, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Ndërkohë pavarësisht bashkëpunimeve dhe marrëveshjeve të deritanishme, bashkëpunimi me sektorin privat mbetet jashtëzakonisht i rëndësishëm kur bëhet fjalë për krijimin e vendeve të punës, rritjen ekonomike dhe punësimin e të rinjve, veçanërisht të atyre që i takojnë grup moshës 15-29 vjeç.



partners@partnersalbania.org

WWW

www.partnersalbania.org

Projekti WB&T for EmploYouth po zbatohet nga:



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

